



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 19/2018 (JR)
Datë 11.10.2018

Vendim nr. 3 (JR)
Datë 07.02.2019

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Sokol Çomo	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 07.02.2019, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar John Leonardo, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Selimi, gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

OBJEKT: Shqyrtimi i vendimit nr. 52, datë 30.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, miratuar me ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (në vijim Aneksi i Kushtetutës); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 58, 61, 62, 63, 65, 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, shqyrtoi pretendimet e kërkesat e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 52, datë 30.07.2018, ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Shkëlzen Selimi, me funksionin gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë Tiranë.”

Ky vendim është marrë bazuar në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 55, pika 5, në nenin 4, pika 2, në nenin 58, pika 1, germa “ç”, si dhe në nenin 61, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016.

Vendimi nr. 52, datë 30.07.2018, është marrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Shkëlzen Selimi, bazuar vetëm në vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, pasi nga Komisioni është konkluduar se kanë rezultuar të vërtetuara:

a) Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, duke fshehur se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

b) Subjekti i rivlerësimit ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, mbështetur në standardet e kontrollit të përcaktuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016.

c) Ndaj subjektit të rivlerësimit ngrihen dyshime të arsyeshme se ai mund të vihet lehtësisht nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.

ç) Disponohen të dhëna nga ku ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike.

II. Shkaqet e ankimit

2. Kundër vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Selimi, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimi nr. 52, datë 30.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë duke paraqitur shkaqet e mëposhtme.

A. Shkaqe që lidhen me çështje të natyrës procedurale dhe procesit të rregullt

3. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pretendimin për shqyrtimin e çështjes në seancë publike, në zbatim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i parë lidhur me shqyrtimin e provave të paraqitura nga subjekti në funksion të provimit të fakteve që sipas tij provojnë pretendimin për gjendjen në konfliktin e interesit të komisioneres Valbona Sanxhaktari.

4. Trupi gjykues i Komisionit ka qenë i njëanshëm dhe, për këtë shkak, vendimi i Komisionit është i pavlefshëm. Këtë njëanshmëri subjekti e lidh me:
 1. pretendimin e tij për konflikt të hapur të interesit të komisioneres relatores Valbona Sanxhaktari;
 2. pretendimin e tij për vënien e procesit të rivlerësimit në favor të një pale private dhe konkretisht të medias “{***}”, me aksionare kryesore znj. V. H.;
 3. pretendimin se i gjithë trupi gjykues është vënë nën presionin mediatik të televizionit “{***}”, i cili e ka sulmuar atë mediatikisht për arsytet e mësipërme.
5. Gjatë shqyrtimit në Komision është cenuar zhvillimi i një të procesit të rregullt ligjor dhe nuk janë zbatuar kërkesat e Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit për të tria kriteret.
6. Shqyrtimi i çështjes nga Komisioni, sipas subjektit, është bërë në cenim të së drejtës për t’u mbrojtur dhe të së drejtës për t’u dëgjuar gjatë procesit dhe gjatë procedurës së ndreqjes së gabimit të vendimit nr. 5, datë 17.09.2018, pretendim që në thelb lidhet me mospasjen mundësi të njohjes me dokumentacionin e klasifikuar që ka shërbyer për ngarkimin e subjektit me përgjegjësi disiplinore sipas ligjit.
7. Procesi i rivlerësimit dhe vendimmarrja e trupit gjykues për subjektin, nuk ka respektuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, përfshirë këtu edhe mungesën e vendimeve të ndërmjetme të trupit gjykues për marrjen e provave të sjella nga subjekti dhe, për pasojë, mungesën e vlerësimit të tyre.
8. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka zbatuar parimet minimale të procesit të rregullt e të drejtë, nuk ka pasur cilësinë e një organi të tretë të paanshëm dhe nuk mund të konsiderohet si gjykatë e krijuar me ligj, sipas nenit 6 të KEDNj-së dhe nenit 42 të Kushtetutës.

B. Shkaqe ankimi për konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe ligjit material

9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në arsyetimin e vendimit ka mungesa të pasqyrimin të fakteve, pasqyrim të pasaktë e të rremë të rrethanave të faktit, pasqyrim të fakteve të pahetuara dhe konkluzione alogjike. Konkretisht këto pretendime lidhen me:
 1. parashtrimin se trupi gjykues gënjen në pikën 33.1 të vendimit, ku thuhet se makina BMW është në pronë të I. Ç.;
 2. parashtrimin se nuk i është adresuar asnjë pyetje për shtetasin A. I..
10. Subjekti i rivlerësimit pretendon se rrethanat e faktit për raportin e DSIK-së dhe rezultatet e hetimit për gjetjen/“ngjarjen” që e lidh me shtetasin F. D., në kushtet kur nuk i janë vënë në dispozicion raportet e ShISH-it për “ngjarjen”, detyrohet t’i paraqesë sipas dijenisë së tij.
 - 10.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon se, pas hetimit të thelluar, është rrëzuar lidhja e tij me “ngjarjen”, por, në kundërshtim të plotë me procedurën e ndjekur, trupi gjykues nuk e ka kthyer për rivlerësim, por ka vazhduar me hetim të mëtejshëm për të gjetur ndonjë rast të mundshëm kundër tij.

10.2 Në raportin e DSIK-së për lidhjen me shtetasin F. D., mungon analiza nëse papërshtatshmëria e subjektit për të vazhduar detyrën ka ardhur për shkak të një raporti të krijuar për shkak të detyrës apo për shkak të njohjes shoqërore.

11. Sipas subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues ka shfaqur njëanshmëri në përkufizimin e shtetasit I. Ç. dhe A. D. si persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe përmendjen e tyre padrejtësisht në arsyetimin e vendimit, duke parashtruar se shtetasit I. Ç. dhe A. D. nuk janë proceduar penalisht.
12. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshti në lidhje me gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar për përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, të shfaqur në formën e ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike me qëllim mosekstradimin e shtetasit A. I..
13. Sipas subjektit të rivlerësimit, informacioni i përcjellë nëpërmjet raportit të ShISh-it ka natyrë hakmarrëse, duke qenë se ka ekzistuar situata e konfliktit të interesit të personave që i hartojnë këto raporte me subjektin e rivlerësimit, konflikt i cili megjithëse ka vlerë thelbësore nuk është verifikuar dhe as nuk përmendet në vendim përfundimtar.
14. Sipas subjektit të rivlerësimit, vlerësimi i figurës është bërë në shkelje të parimit të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016 për një kontroll objektiv dhe pa ndikime të figurës, duke pretenduar se organi kompetent që harton raportin për vlerësimin e figurës është një organ me varësi politike (i anshëm) dhe, si i tillë, është organ i politizuar dhe joneutral dhe i besueshëm.

III. Rrethanat e çështjes

15. Nga shqyrtimi i akteve që janë administruar gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Selimi ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Vlorë nga viti 1999 e deri në vitin 2011. Në qershor të vitit 2011, ai është emëruar në pozicionin e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë, Tiranë. Subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Selimi, bazuar në pikën 3 të nenit 179/b të Aneksit të Kushtetutës, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*. Ai është trajtuar nga Komisioni si subjekt me përparësi në shortin e hedhur prej tij, më datë 30.11.2017, dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, si anëtar i Gjykatës së Lartë, në zbatim të nenit 4, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
16. Për subjektin e rivlerësimit Shkëlzen Selimi, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, ka kryer kontrollin e figurës së tij, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në funksion të qëllimit që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, ka dërguar një raport të arsyetuar, duke konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi.
17. Komisioni, për subjektin e rivlerësimit Shkëlzen Selimi, ka përfunduar hetimin administrativ vetëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe me vendimin nr. 52, datë 30.07.2018, ka konkluduar:
“[...] bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, zhvilloi seancën dëgjimore publike, ku subjekti i rivlerësimit vendosi të mos qëndrojë për të dëgjuar e dhënë shpjegime, lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe mori në shqyrtim të

gjitha pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës. Për këto arsye, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, edhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2, 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi, me funksionin gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë Tiranë [...]”.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit me natyrë procedurale dhe që lidhen me procesin e rregullt ligjor

Në vlerësim dhe shqyrtim të procedurës administrative të ndjekur gjatë procesit të rivlerësimit nga Komisioni dhe shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale që ka paraqitur subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim trupi gjykues), arsyeton si më poshtë:

18. Trupi gjykues mori fillimisht në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit, të paraqitur në ankim dhe të shtjelluar edhe në parashtrimet me shkrim të paraqitura në zbatim të nenit 49, paragrafi 2 i ligjit nr. 49/2012, në lidhje me shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike për shkak të nevojës së administrimit të disa provave të reja, të cilat do të provonin pretendimet e tij për qenien e komisioneres Valbona Sanxhaktari në kushtet e konfliktit të interesit dhe, për pasojë, zhvillimin e një procesi të parregullt ligjor. Provat e konsideruara si të tilla prej subjektit të rivlerësimit, ishin:
- <https://balkanweb.com/akuza-mbi-komisioneren-e-vettingut-berisha-nxjerr-mesazhin-ka-pasur-kontakte-me-trafikante-e-kriminele/>
 - *Informacion nga sistemi TIMS për daljet jashtë vendit të Komisioneres znj. Valbona Sanxhaktari.*
 - *Informacion nga sistemi TIMS për deportimin e shtetasit A. R. (S.) nga Policia Italiane.*
 - *Ekstrakt nga QKB, datë 21.09.2018 (29 fletë)*
 - *Dokument i nxjerrë nga fashikulli i gjykimit të çështjes nr. {*****}-2017 akti, të regjistruar pranë Gjykatës së Lartë, dosja “Hakmarrja për Drejtësi”*
 - *Dokument i nxjerrë nga fashikulli i gjykimit të çështjes nr. {*****}-2017 akti, të regjistruar pranë Gjykatës së Lartë, çështja penale nr. {***} Tiranë, me nr. {***}prot., datë {**}.{**}.1996*
 - <http://top-channel.tv/2018/06/18/gerdeci-u-mbyll-me-korrupsion/>
 - <http://top-channel.tv/2018/06/20/shkarkoni-shkelzen-selimin-proteste-e-shoqerise-civile-para-vettingut/>
 - <http://top-channel.tv/2018/06/19/ana-veizi-kerkon-drejttesi-si-e-ze-gjumi-shkelzen-selimin-me-vrau-babane-per-se-dyti/>
 - <http://top-channel.tv/2018/06/26/gjyqtari-i-gerdecit-ne-makinen-e-te-pandehurit/>
 - <http://top-channel.tv/2018/06/07/gjyqtari-i-krimeve-para-vettingut-shkelzen-selimi-vendosi-per-gerdecin-dhe-21-janarin/>
 - <http://top-channel.tv/2018/06/08/gjyqtari-qe-shfrytezon-drejtisine/>
 - <http://top-channel.tv/2018/06/13/pasuria-e-shkelzen-selimit-gjyqtari-me-rroge-shteti-bleu-karburant-me-250-mije-euro/>

- <http://top-channel.tv/2018/07/17/shprese-nga-vettingu-shkarkime-ne-gjykatene-mbylli-korrupsionin-gerdecit-dhe-21-janarit/>
- <http://top-channel.tv/2018/07/26/ekskluzive-pergjimi-i-gjyqtarit-selimi-shish-ndihmoi-te-arrestuarin-te-lirohej-nga-burgu/>

19. Së pari, në vlerësim të provave të reja të pretenduara prej subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se pothuajse të gjitha u përkasin burimeve të hapura, të publikuara në adresa të ndryshme të platformave elektronike, për pasojë lehtësisht të aksesueshme edhe prej trupit gjykues, duke gëzuar statusin e fakteve të njohura nga Kolegji, në kuptim të nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “Faktet e njohura për Komisionin dhe faktet e njohura botërisht, si edhe faktet e prezumuara nga ligji, nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”. Duke konsideruar këtë status, trupi gjykues vlerësoi si të panevojshëm kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike për administrimin e këtyre provave, duke i konsideruar ato si të njohura dhe faktet që subjekti pretendon të provojë me to si të mirëqena dhe të vërteta. Mbështetur në këtë vlerësim, trupi gjykues i gjen të paplotësuara kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 e të paragrafit 1 të tij, që do të legjitimonin kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike për të analizuar faktet që rezultojnë nga provat e pretenduara si të reja prej subjektit të rivlerësimit e të renditura në ankimin e paraqitur prej tij.
20. Në arsyetimin e shkaqeve të tjera të ankimit dhe të atyre që lidhen me konfliktin e interesit, trupi gjykues vlerëson të japë argumentin e tij duke pranuar si të vërteta faktet e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, të cilat gjejnë pasqyrim në provat që ai pretendon të administrohen, por pa qenë e nevojshme marrja e tyre në një formë të caktuar procedurale, por duke u konsideruar si fakte të njohura nga Kolegji. Për këto arsye, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm në dhomën e këshillimit, vendosi të refuzojë kërkesën e subjektit për marrjen e provave të reja dhe kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, në zbatim të neneve 49, pika 6, germa “a” dhe 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016 dhe të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012.
21. Lidhur me shkakun e paraqitur në ankim nga subjekti i rivlerësimit, në të cilin pretendon për njëanshmëri të trupit gjykues, pasi komisionerja relatore Valbona Sanxhaktari ka qenë në kushtet e konfliktit të hapur të interesit, veprim të cilin e konsideron si shkelje të rëndë procedurale të parashikuar nga neni 72, paragrafi i parë, pika 3 e Kodit të Procedurës Civile dhe neni 30, gerrat “a”, “b” dhe “g” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 44/2015), që e bën absolutisht të pavlefshëm vendimin e marrë, trupi gjykues i Kolegjit e konsideron si një pretendim të pabazuar në ligj, duke analizuar sa vijon.
22. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim njëanshmëri të trupit gjykues për shkak të konfliktit të interesit të komisioneres relatore Valbona Sanxhaktari, sepse ish-bashkëshorti i saj, shtetasi A. R., është hetuar nga organi i prokurorisë si person i dyshuar si anëtar i organizatës kriminale “Hakmarrja për Drejtësi”. Në ankim, subjekti parashtron se edhe pse për z. R. çështja u pushua, kjo çështje vazhdoi për anëtarët e tjerë të organizatës kriminale, shokë të këtij shtetasi, duke shpjeguar se kjo çështje është gjykuar prej tij në Gjykatën e Lartë në cilësinë e gjyqtarit relator dhe ky fakt e bën komisioneren të jetë e njëanshme dhe e ndikuar negativisht në drejtim të subjektit të rivlerësimit.

23. Trupi gjykues çmon se analiza për këtë pretendim duhet të kryhet mbështetur në dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative, të cilave neni 27 i ligjit nr. 84/2016 u referohet në mënyrë të posaçme. Kjo e fundit është një normë që rregullon posaçërisht kushtet e përjashtimit të një gjyqtari nga një proces gjyqësor, ndërkohë që neni 27 i ligjit nr. 84/2016 parashikon nenin 30 të Kodit të Procedurës Administrative si bazë ligjore referuese për të rregulluar situatën e konflikti të interesit për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, veçanërisht anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në analizë të dispozitave ligjore që rregullojnë konfliktin e interesit dhe konkretisht të nenit 30 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” (në vijim ligji nr. 44/2015), germa “a”, “b” dhe “g” të kësaj dispozite përcaktojnë se një nëpunës publik (në rastin konkret, komisionerja relatore) kërkohet të mos përfshihet në një procedurë administrative kur bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit të tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim. Nga sa konstatohet nga aktet e administruara në dosje gjatë hetimit administrativ, por edhe nisur nga sa parashtron vetë në ankim subjekti i rivlerësimit, si dhe duke pranuar si të vërteta faktet e paraqitura prej tij, të cilat gjejnë pasqyrim në “provat e reja” të analizuara në paragrafët e mësipërm, rezulton se shtetasi A. R. nuk ka qenë bashkëshorti i komisioneres relatore në kohën e zhvillimit të procedurës administrative, kohë në të cilën ai ka pasur statusin e ish-bashkëshortit për shkak të zgjidhjes së martesës shumë kohë më parë. Duke qenë në statusin e ish-bashkëshortit, referuar përcaktimeve të nenit 30, germa “b” e ligjit nr. 44/2015 të sipërcituar, i cili parashikon se *bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim*, ai nuk rezulton të jetë i përfshirë në rrethin e personave që mund të vendosin në kushtet e konfliktit të interesit komisioneren relatore të trupit gjykues të Komisionit. Në të njëjtën situatë paraqitet rasti edhe në këndvështrim të parashikimeve që bën ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9367/2005) për rrethin e personave të lidhur me zyrtarin, i cili mund të gjendet në kushtet e konfliktit të interesit. Neni 3, paragrafi 11 dhe neni 5 i ligjit nr. 9367/2005 nuk parashikojnë ish-bashkëshortin si një person që mund të konsiderohet person i lidhur me zyrtarin, element që përjashton analizën e mëtejshme për ekzistencën e kushteve që parashikon ky ligj për situatën e konfliktit të interesit dhe pasojave e të mënyrës për zgjidhje apo shmangien e këtij konflikti. Ligji merr përsipër ta trajtojë këtë marrëdhënie jo si një marrëdhënie që mund ta vendosë automatikisht anëtarin e organit në kushtet e konfliktit të interesit, por si një marrëdhënie që do të çmohet rast pas rasti në varësi të rrethanave të çështjeve konkrete.
24. Duke vijuar analizën, edhe në rast se do të kishim një përfshirje të këtij shtetasi në rrethin e personave që potencialisht mund të krijonin situatën e konfliktit të interesit, në zbatim të nenit 30, germa “dh” e Kodit të Procedurave Administrative kërkohet që ndaj këtij personi të ketë nisur një proces gjyqësor prej palës që është në procedurën administrative. Trupi gjykues i Kolegjit, edhe pse gjykon se nuk ndodhemi në kushtet e aplikimit të nenit 30, germa “dh” e ligjit nr. 44/2015, në përgjigje të pretendimit të subjektit arsyeton sa vijon: Në analizë të pretendimit të subjektit, procesi gjyqësor që është zhvilluar në Gjykatën e Lartë kundër anëtarëve të organizatës “Hakmarrja për Drejtësi”, duhej të kishte pasur shtetasin R. si një ndër të pandehurit e çështjes, ndërkohë që edhe vetë subjekti parashtron se jo ai vetë, por shokët e tij të supozuar kanë qenë pjesë e këtij

procesi, me cilësinë e të pandehurve. Për më tepër, logjika e këtij pretendimi të subjektit kërkon që procesi gjyqësor të jetë finalizuar me vendimmarrje kundër personit ose anëtarit apo të afërmit, në mënyrë që pretendimi për njëanshmëri dashakeqe ndaj subjektit natyrshëm të reflektojë një sjellje jo vetëm të njëanshme, por edhe dashakeqëse të anëtarit të organeve të rivlerësimit ndaj personit (në këtë rast, subjektit të rivlerësimit) që kishte ndërmarrë të njëjtën sjellje ndaj personit të afërm të tij. Duke analizuar situatën e prezantuar prej vetë subjektit të rivlerësimit dhe përmbajtjen e vendimit nr. {***}, datë {**}.{**}.2016, të Gjykatës së Lartë, konstatohet se vendimi i dhënë nga trupi gjykues i Gjykatës së Lartë, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e gjyqtarit relator për çështjen e organizatës “Hakmarrja për Drejtësi”, është një vendim në favor të të pandehurve anëtarë të kësaj organizate. Ky vendim i Gjykatës së Lartë i datës {**}.{**}.2016 ka vendosur prishjen e vendimit nr. {***} datë {**}.{**}.2009, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda - *vendim që për anëtarët e kësaj organizate kishte dhënë dënime me burgim të përjetshëm apo me 25 vjet heqje lirie* - duke vendosur kthimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate. Siç rezulton nga konsultimi i burimeve të hapura, rigjykimi ka përfunduar me deklarinimin të pafajshëm të anëtarëve të kësaj organizate, sipas vendimit nr. {***}, me nr. regjistri themeltar {***}, datë {**}.{**}.2017, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

25. Duke konkluduar në lidhje me këtë shkak, në mënyrë të përmbledhur trupi gjykues arsyeton se: a) shtetasi A. R. nuk është person i përfshirë në rrethin e personave sipas nenit 30, germa “b” e ligjit nr. 44/2015; b) për të nuk provohet as interesi i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë, për dhënien e masës së shkarkimit ndaj subjektit Shkëlzen Selimi, pra për të pasur një qasje negative ndaj tij, pasi nga faktet e analizuara rezulton se vetë subjekti i rivlerësimit ka kryer një gjykim të finalizuar me një vendimmarrje në favor të personave (anëtarëve të organizatës “Hakmarrja për Drejtësi”), që indirekt vetë ai i konsideron si të lidhur/shokë me shtetasin A. R..
26. Lidhur me shkakun tjetër i cili, sipas subjektit të rivlerësimit, e ka vendosur trupin gjykues të Komisionit në kushtet e cenimit të paanësisë, ka të bëjë me pretendimin se procesi i tij i rivlerësimit është vendosur në shërbim të një prej palëve ndërgjyqëse, në një proces ende në shqyrtim nga ana e subjektit të rivlerësimit, që i përket kërkesëpadisë së ngritur nga aksionarja V. H. e grupit mediatik “{***}” kundër aksionarëve të tjerë të tij. Në ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo media ka qenë e interesuar për moskonfirmimin e tij në detyrë dhe se ndikimin e saj për të arritur këtë qëllim e ka bërë si nëpërmjet transmetimit të kronikave të shumta denigruese për subjektin e rivlerësimit Shkëlzen Selimi, por edhe nëpërmjet ndërhyrjeve të drejtuesve të saj të lartë ekzekutive të komisionerjve relatore e trupit gjykues të Komisionit. Për këtë shkak, në ankim subjekti pretendon për lidhje të ngushta miqësie familjare midis komisioneres relatore dhe shtetasit A. J. , me detyrë administrator dhe aksionar i shoqërisë “{***}”, ku si drejtuese e Këshillit Mbikëqyrës është shtetasja V. H..
27. Referuar këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit të prezantuar në ankim, trupi gjykues shqyrtoi statusin e shtetasit A. J. , në kuptim të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016 e nenit 30 të ligjit nr. 44/2015 dhe konstatoi se ai nuk bën pjesë te rrethi i personave të lidhur të anëtarit të organit kolegjial, sipas parashikimeve të germës “b” të nenit 30 të ligjit nr. 44/2015. Për shkak të referimit që bën neni 27 i ligjit nr. 84/2016 te ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i

ndryshuar, shqyrtimi i këtij pretendimi të parashtruar në ankim u analizua prej trupit gjykues edhe në këndvështrim të parashikimeve të këtij ligji. Kështu, sipas nenit 3, pika 1 e këtij ligji: *“Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.* Ndërsa neni 5 i të njëjtit ligj *“interesa privatë të zyrtarit”* përkufizon ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga:

a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;

b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;

c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;

ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;

d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;

dh) marrëdhënie:

i) familjare apo të bashkëjetesës;

ii) të komunitetit;

iii) etnike;

iv) fetare;

v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;

e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

Ndërsa në nenin 3, paragrafi 11 i ligjit nr. 9367/2005, parashikohet përkufizimi i rrethit të personave të lidhur të zyrtarit sipas të cilit: *“Person i lidhur me një zyrtar” është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore, sipas nenit 5 të këtij ligji, me zyrtarin.*

Pra, nga dispozitat e ligjit nr. 9367/2005, statusin e personit të lidhur të zyrtarit (në këtë rast të komisioneres) e mbart ai rreth personash fizikë apo juridikë që ka lidhje pasurore apo interesi me zyrtarin, duke referuar për përcaktimin e konceptit të interesit të parashikimi që bën neni 5 i ligjit nr. 9367/2005, i sipërcituar.

28. Duke analizuar dispozitat e cituara më sipër, konstatohet se si ligji specifik i cili rregullon çështjet e konfliktit të interesave nr. 9367/2005, ashtu edhe ligji nr. 84/2016, qenien në konflikt interesi të komisionerit e lidhin në pjesën më të madhe të rasteve me një interes pasuror apo lidhje biznesi të tij, por duke përfshirë edhe lidhjet afektive të miqësisë. Nga aktet e administruara në dosje, por edhe nga shpjegimet e dhëna nga vetë subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij, nuk rezulton që komisionerja relatore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të ketë pasur apo të ketë interesa pasurore apo biznesi me shtetasit A. J. dhe bashkëshorten e tij.

Marrëdhënia e komisioneres Sanxhaktari me shtetasin A. J. , nuk provohet që të jetë një marrëdhënie e njohur miqësie në kuptim të nenit 5, paragrafi 1, germa “dh”, pika v e ligjit nr. 9367/2005, pasi si fakt për të ngritur këtë pretendim ka shërbyer vetëm një udhëtim i pretenduar se është kryer së bashku për në Malin e Zi, pretendim i cili nuk është provuar se është i vërtetë. Përveç kësaj rrethane të pretenduar si më sipër, nuk pretendohet, as

rezultun ndonjë e dhënë tjetër që tregon se marrëdhënia mes tyre ka një natyrë të konsoliduar e të vazhdueshme apo të provojë një raport dinamik e jetëgjatë që do ta përkufizonte atë si një marrëdhënie të njohur miqësie në kuptim të ligjit, të aftë që të arrinte të ndikonte vullnetin e zyrtarit, komisioneres në rastin konkret.

29. Por edhe sikur të pranohet se shtetasi A. J. është një person i lidhur me komisioneren Sanxhaktari për shkak të një lidhjeje të njohur miqësie në kuptim të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 9367/2005, përsëri në analizë të të gjitha normave specifike të të njëjtit ligj, nuk gjendet asnjë dispozitë e veçantë që të parashikojë kufizime për personin e lidhur me zyrtarin në një situatë si rasti në fjalë. Kështu neni 24 i ligjit nr. 9367/2005 parashikon kufizime për personat e lidhur me zyrtarin vetëm për rastet e parashikuara nga neni 23 i tij, parashikime që lidhen me pranimin e dhuratave apo favoreve për zyrtarin në një situatë kur personi i lidhur është ndërmjetësi që ka mundësuar dhënien e dhuratës apo përfitimin e favorit. Parashikimi i ligjit në këto raste lidhet kryesisht me lidhjen e kontratave, aktivitetet që del nga natyra e çështjes objekt gjykimi dhe që pretendohet si e ndikuar prej subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, edhe në paragrafin e fundit të nenit 24 parashikohet se kufizimet nuk përfshijnë personat e lidhur të personave të lidhur me zyrtarin, që do të thotë se ligji merr përsipër të trajtojë një rast konflikti interesi dhe ta klasifikojë si të tillë deri te personat e lidhur me zyrtarin, gjithmonë kur plotësohen kushtet ligjore të përshkruara më lart, dhe jo të parashikojë kufizime apo ndalime për personat e lidhur me personat e lidhur me zyrtarin. Në rast se duke pranuar tërësisht pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se shtetasi A. J. është një person i lidhur me komisioneren Sanxhaktari, shtetasja V. H., duke qenë në cilësinë e aksionares së kompanisë “{***}”, në të cilën shtetasi J. është administrator dhe aksionar, do të ishte një person i lidhur me personin e lidhur të komisioneres (shtetasin J.), përsëri kjo rrethanë do të bënte të pamundur aplikimin e ndonjë kufizimi prej këtij ligji në drejtim të veprimtarisë vendimmarrëse të komisioneres, për shkak të distancës dhe largësisë së lidhjes së shtetasës V. H. me komisioneren Sanxhaktari.

Ligji nr. 9367/2005 parashikon gjithashtu edhe një rregullim tjetër për sa u përket kufizimeve që vijnë për shkak të interesave të personave të lidhur me zyrtarin, ato të rregulluara nga neni 35 i ligjit që të referon te neni 33 i tij. Në këto raste, për qëllim të zbatimit të këtij kufizimi, parashikohet se personat e lidhur me zyrtarin do të konsiderohen vetëm ata të parashikuar si më poshtë:

Person i lidhur, për qëllim të neneve 27 deri 33 të këtij ligji, për kufizimet e interesave privatë të zyrtarëve, të përcaktuar në nenet e tjera të këtij seksioni, janë vetëm bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es. Edhe sipas këtij parashikimi, shtetasi A. J. nuk mundet të gëzojë statusin e personit të lidhur dhe, për më tepër, të passjellë ndonjë detyrim për komisioneren Sanxhaktari, për të kufizuar apo përjashtuar veten e saj nga veprimtaria vendimmarrëse në çështjen objekt gjykimi.

Përfundimisht, në analizë të situatës faktike dhe ligjore të përshkruar më lart, trupi gjykues çmon që pretendimi se komisionerja Valbona Sanxhaktari është gjendur në kushtet e konflikti të interesit për të dyja shkaqet e parashtruara në ankim - marrëdhënien me ish-bashkëshortin dhe faktin e pretenduar, por të paprovuar, se ka udhëtuar jashtë vendit në një rast me shtetasin A. J. - është i pabazuar në ligj dhe, si i tillë, nuk duhet të përkrahët në shqyrtimin e kësaj çështje.

30. Trupi gjykues shqyrtoi gjithashtu pretendimin e subjektit të rivlerësimit që lidhet me efektin ndikues të informacioneve të publikuara e të shpërndara nga media kombëtare “{***}”, si pjesë e një skenari për të denigruar figurën e subjektit të rivlerësimit në sytë e publikut e ndërkombëtarëve dhe për të parapërcaktuar vendimin për shkarkimin e tij. Pavarësisht faktit se subjekti në asnjë rast të ngritjes së pretendimeve në raport me këtë media dhe qenien e tij anëtar i trupit gjykues në çështjen në të cilën janë në konflikt aksionarët e saj, nuk ka shpjeguar shkakun e mosdakordësisë së kësaj pale për qenien e tij anëtar i trupit gjykues në atë proces dhe se si është bërë e mundur që një palë ta konsiderojë atë si kundërshtar apo të padëshirueshëm përderisa nuk është dhënë një vendim për atë çështje apo nuk ka filluar ende shqyrtimi gjyqësor, përsëri në këndvështrimin e vlerësimit të çdo pretendimi të ngritur prej subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues e mori në shqyrtim edhe këtë pretendim. Në të njëjtën mënyrë, trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit për hetimin dhe verifikimin e denoncimit të një shtetasi, të paraqitur pranë Komisionit më datë 26.07.2018 e të shpërndarë nga e njëjta media në të njëjtën datë në mbrëmje, vetëm një ditë para zhvillimit të seancës dëgjimore, për të cilin Komisioni nuk i kishte dhënë subjektit mundësinë të mbrohej e dëgjohej.

Fillimisht duhet të nënvizohet fakti se rezulton nga verifikimi i të gjitha akteve që gjenden në fashikullin e përcjellë prej Komisionit, se pavarësisht që në vendimin e Komisionit arsyetohet mbi fakte e rrethana nga ato që rezultojnë të jenë pjesë e materialit “sekret” që shoqëron denoncimin në fjalë, të gjitha ato të dhëna janë verifikuar e nxjerrë prej hetimit administrativ të kryer nga vetë Komisioni dhe janë prezantuar para subjektit të rivlerësimit përgjatë gjithë hetimit, çka hedh poshtë në këtë mënyrë si të pavërtetë faktin se këto të dhëna të përfutuara nga ky material denoncues janë përdorur për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Përpos kësaj, vetë Komisioni në vendimin e tij nr. 52, datë 30.07.2018, siç edhe i ka komunikuar subjektit të rivlerësimit, ka vendosur të mos konsiderojë e të mos hetojë për faktet e pasqyruara në materialin denoncues, duke qenë se momenti i paraqitjes së tij përkonte me përfundimin e hetimit administrativ.

Në të njëjtën logjikë, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se hetimi i mëtejshëm prej tij i këtij denoncimi, në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, nuk do të sillte asnjë element të ri për shqyrtimin e çështjes, pasi rrethanat e pasqyruara në të, edhe sikur të konsideroheshin të vërteta, nuk do të jepnin asnjë të dhënë të vlefshme e të rëndësishme për çështjen, e cila mund të ndikonte në zgjidhjen e saj.

Fakti që ky material denoncues, së bashku me informacione apo publikime të tjera janë bërë publikë nga media “{***}” përgjatë procesit të rivlerësimit, duke abstraguat vlerësimin mbi vërtetësinë apo autenticitetin e tyre, konsiderohet nga Kolegji si rrethanë që ka mbetur jashtë ndikimit të trupit gjykues në Komision, për sa kohë që asnjë nga këto informacione, në asnjë formë, qoftë edhe të tërthortë, nuk është bërë pjesë e vlerësimeve të këtij trupi në drejtim të vlerësimit të kriterit të figurës për subjektin e rivlerësimit. Trupi gjykues çmon se përhapja e informacioneve nëpërmjet medias së shkruar apo vizive është një proces që del jashtë kompetencës vëzhguese apo kontrolluese të organeve të rivlerësimit dhe se detyra e tyre është që të vlerësojnë këto të dhëna nëpërmjet një procesi transparent e të drejtë, duke respektuar të drejtat ligjore të subjektit të rivlerësimit. Për sa kohë që në çështjen objekt gjykimi nuk gjenden të dhëna të shpërndara mediatikisht, të

cilat janë bërë pjesë e arsyeve apo shkaqeve për shkarkimin e subjektit, trupi gjykues çmon se ato nuk kanë ndikuar në zhvillimin e një procesi të drejtë e të baraslarguar nga të gjitha influencat e në respektim të të drejtave e lirive të subjektit të rivlerësimit.

31. Trupi gjykues shqyrtoi pretendimin e subjektit për sa i përket zhvillimit të një procesi të parregullt ligjor, referuar faktit që procesi i rivlerësimit për të është zhvilluar me vlerësimin e vetëm të një kriteri siç është ai i figurës. Ashtu siç është shprehur edhe më parë Kolegji në vendimet e tij, konkretisht, vendimi nr. 6/2018(JR) dhe 11/2018(JR), trupi gjykues e gjen të bazuar ligjërisht dhe të drejtë vendimin e Komisionit për përfundimin e procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi vetëm mbi kriterin e kontrollit të figurës.
32. Në kuptim edhe të qëllimit të shpallur në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës, e cila parashikon: “Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit nuk ka për qëllim të verifikojë detyrimisht të tria kriteret e vlerësimit për subjektet e rivlerësimit, si një proces që përcakton standardin e tyre në përmbushje të detyrës apo gradën e vlerësimit të tyre, por kërkon që ky proces të zhvillohet në funksion të rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, si edhe te garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kontekst të qëllimit të Kushtetutës, nuk do të kishte asnjë vlerë dhe qëllim të ligjshëm vazhdimi i procedurës për rivlerësimin e kriterëve të tjera, për sa kohë arrihet në konkluzionin se edhe në verifikim të një kriteri, subjekti i rivlerësimit duhet të largohet nga sistemi i drejtësisë me qëllim që besimi i publikut të kthehet dhe sistemi të mirëfunksionojë.
33. Për këtë shkak ankimi, trupi gjykues sjell në vëmendje parashikimet e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Kjo dispozitë ligjore përcakton qartazi se rivlerësimi është një proces i cili jo domosdoshmërisht e lidh fillimin dhe finalizimin e tij me shqyrtimin e tri kriterëve, kjo në lidhje të ngushtë edhe me nenin 59 të këtij ligji, i cili në pikën 1 parashikon se për konfirmimin në detyrë duhet që subjekti të rezultojë se përmbush të tria kriteret dhe si i tillë arrin të ketë në mënyrë kumulative nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.
34. Fakti që neni 59 i ligjit nr. 84/2016, me qëllim konfirmimin në detyrë, kërkon domosdoshmërisht vlerësimin pozitiv të të tria kriterëve së bashku, nuk ndalon KPK-në që në rastet kur rezulton se nga hetimet e kryera, për një apo dy kriterë subjekti nuk arrin një nivel të besueshëm, Komisioni mund të përfundojë rivlerësimin duke e bazuar edhe në një kriter. Ky qëndrim është edhe në funksion të moszvarritjes së procesit të rivlerësimit me hetime dhe rivlerësime për kriterë që edhe nëse rezultojnë me nivel minimal kualifikues (kjo referuar kontrollit të pasurisë apo vlerësimit profesional), nuk ndryshojnë në tërësi rezultatin mbi procesin e rivlerësimit të subjektit, por përkundrazi e zvarritin dhe rrisin kostot e tij. Nga ana tjetër, trupi gjykues thekson se ashtu siç ka referuar Komisioni në vendimin nr.52, datë 30.07.2018, marrja e vendimit mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin Shkëlzen Selimi vetëm mbi kriterin e kontrollit të figurës, nuk përben në asnjë rast gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë profesional.

35. Trupi gjykues shqyrtoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur, për shkak të mospasjes mundësi të njohjes me raportin e hartuar nga DSIK-ja, i cili ka konstatuar papërshtatshmërinë e figurës së tij për vazhdimin e detyrës, si edhe me mospasjen mundësi të njohjes më dokumentacionin e klasifikuar. Nga analizimi i akteve të administruara në dosje dhe veçanërisht korrespondencës mes Komisionit e subjektit të rivlerësimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur informim të mjaftueshëm lidhur me hetimin e kryer nga Komisioni në funksion të procesit të tij të rivlerësimit dhe në funksion të realizimit të së drejtës së tij për t'u mbrojtur. Kështu, nga aktet e administruara, rezulton se Komisioni dhe subjekti i rivlerësimit gjatë fazës së hetimit administrativ kanë komunikuar mbi dhjetë herë, si në rrugë elektronike ashtu edhe shkresore, gjatë të cilave subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet e tij për çështjet e pyetura nga Komisioni që në fazat fillestare të hetimit administrativ, komunikime që janë integruar pothuajse të plota edhe në pjesën arsyetuese të vendimit të Komisionit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegimet dhe kundërshtitë e tij nëpërmjet aktit të cilësuar si “Shpjegime të subjektit të rivlerësimit lidhur me rezultatet paraprake” të hetimit të kryer nga Komisioni. Nga analizimi i të gjitha këtyre komunikimeve, trupi gjykues arrin në konkluzionin se Komisioni nëpërmjet komunikimit me subjektin, përmes procesit të adresimit të pyetjeve për çështjet e individët që më pas janë konsideruar si shkaqe që e konsideronin subjektin si të papërshtatshëm, i ka zbuluar e komunikuar subjektit, në një nivel të mjaftueshëm e të arsyeshëm rrethana e fakte, apo identitete personash për të cilët, në përfundim të procesit të hetimit administrativ, atij i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën dhe për të cilat është vendosur masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.
36. Siç do të arsyetohet në detaje më poshtë, rezulton se Komisioni nëpërmjet një procesi të kujdesshëm, të ekuilibruar dhe proporcional, në funksion të garantimit të të drejtave të subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, me qëllim realizimin e së drejtës së tij për t'u mbrojtur dhe garantimit të mbrojtjes së sekretit shtetëror në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, të ndryshuar, si dhe angazhimeve të shtetit shqiptar me partnerët ndërkombëtarë, në kuptim të nenit 39, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, i ka komunikuar subjektit të rivlerësimit që në një fazë të hershme të hetimit administrativ ato fakte e rrethana, që më pas do e ngarkonin atë me përgjegjësi disiplinore në kuptim të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës e nenit 61, pikat 2 e 3 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, në analizë të këtij komunikimi, rezulton që gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit të ketë dhënë shpjegime e paraqitur prova duke ushtruar të drejtën e tij për t'u mbrojtur.
37. Në vijim të sa më lart, lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për mosnjohjen e raportit të plotë të DSIK-së, i cili ka konstatuar papërshtatshmërinë e tij për ushtrimin e detyrës, trupi gjykues konstaton se ky akt është administruar nga Komisioni më datë 15.11.2017, si një akt i klasifikuar “sekret shtetëror” dhe është deklasifikuar pjesërisht më datë 09.05.2018. Nga aktet e administruara rezulton se raporti i deklasifikuar pjesërisht i është bërë i njohur nga Komisioni subjektit të rivlerësimit. Ky dokument në pjesën e deklasifikuar sqaron se për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, u është dërguar kërkesë për verifikim organeve ligjzbatuese, të ngarkuara me kompetencën për dhënien e këtij informacioni, si dhe atyre të shteteve të huaja partnere. Në këto kushte, rezulton se subjekti i rivlerësimit është vënë në dijeni mjaftueshëmrisht jo vetëm për rrethana e fakte

që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, por nëpërmjet këtij raporti ka marrë dijeni edhe për burimin e informacioneve mbi të cilat janë bazuar konkluzionet e tij, duke ezauruar në këtë mënyrë një kusht të rëndësishëm në drejtim të garantimit të detyrimit kushtetues të organeve të rivlerësimit për procesin e rregullt ligjor.

38. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje, trupi gjykues konstaton se si gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, ashtu edhe në përfundim të tij e deri në zhvillimin e seancës dëgjimore publike, subjekti i rivlerësimit ka pasur të gjitha mundësitë për të dhënë shpjegime e për të ushtruar të drejtën për t'u mbrojtur në lidhje me përfshirjen e tij në ngjarje dhe me individë të identifikuar si lidhje të papërshtatshme të cilat i janë bërë të njohura subjektit nga Komisioni që në fillimet e hetimit administrativ. Për këto arsye, trupi gjykues e gjen jo të drejtë dhe të argumentuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenim të ushtrimit të së drejtës për t'u mbrojtur.
39. Në lidhje me pretendimin e paraqitur në ankim, sipas të cilit subjekti nga Komisioni i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar gjatë procesit të rivlerësimit, duke e fokusuar kryesisht këtë pretendim në drejtim të njëanshmërisë së trupit gjykues, për sa kohë ky trup e kishte paracaktuar vendimin e tij, gjë që dëshmohet, sipas tij, edhe nga fakti se trupi nuk mori fare kohë për shqyrtimin dhe reflektimin e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me rezultatet paraprake të hetimit, por menjëherë përcaktoi ditën e nesërme si ditën që do të zhvillohej seanca dëgjimore publike, trupi gjykues vlerëson të nënvizojë faktin se e drejta për t'u dëgjuar është një e drejtë e njohur nga neni 55 i ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Kodi i Procedurës Administrative, e cila parashikohet të realizohet nëpërmjet dëgjimit të palës në seancë dëgjimore.
- Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerëson se është pikërisht seanca dëgjimore publike mundësia dhe garancia e parashikuar nga ligji në të cilën, subjekti i rivlerësimit ushtron të drejtën për t'u dëgjuar nëpërmjet parashtrimit të argumenteve, opinioneve apo diskutimeve ligjore të tij mbi rezultatet e arritura prej Komisionit, në këndvështrim edhe të provave të reja të paraqitura prej tij, si edhe mundësinë ligjore për të paraqitur në një fazë finale ato prova që nuk janë mundur të paraqiten gjatë fazës së hetimit administrativ.
40. Në verifikim të këtij shkaku ankimi rezulton, jo vetëm nga analiza e përmbajtjes së vendimit të Komisionit, por edhe nga një analizë e procesverbalit të seancës dëgjimore, se subjekti i rivlerësimit me vullnetin e tij të lirë ka zgjedhur të braktisë këtë fazë procedurale të procesit të rivlerësimit, duke hequr dorë nga ushtrimi i kësaj të drejte, megjithëse ai ka qenë i thirrur për t'u dëgjuar rregullisht prej Komisionit. Arsyeja e pretenduar prej tij për largimin nga seanca dëgjimore nuk e zhbën faktin e ndodhur, se ai është larguar vetë duke zgjedhur të mos e ushtrojë këtë të drejtë dhe sigurisht që në ato momente ka vlerësuar se kjo sjellje do të ishte forma më e mirë për të realizuar mbrojtjen e interesave të tij. Verifikimi i kësaj rrethane e bën të padrejtë e të paarsyeshëm pretendimin e tij për cenim të kësaj të drejte nga Komisioni dhe mosrespektim të garancive për procesin e rregullt ligjor.
41. Edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenim/mohim të së drejtës për t'u dëgjuar, për sa u përket procedurave të ndjekura për korrigjimin e vendimit nr. 52, datë 30.07.2018, mohim i cili sipas tij e bën aktin administrativ të paligjshëm me pasojë

pavlefshmërinë juridike, trupi gjykues e vlerëson gjithashtu të padrejtë e të pambështetur në ligj.

Në analizë të rrethanave të faktit, rezulton se trupi gjykues i Komisionit ka vendosur të bëjë kryesisht një korrigjim të një gabimi të konsideruar material në vendimin nr. 52, datë 30.07.2018, në pjesën e përcaktimit të bazës ligjore mbi të cilën mbështetet vendimi i shkarkimit për subjektin e rivlerësimit, duke saktësuar bazën ligjore jo vetëm si ajo e nenit 61, paragrafi i tretë, por edhe paragrafin e dytë të këtij neni të ligjit nr. 84/2016.

42. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se referimi te ligji për gjykimin administrativ për korrigjimin e vendimit është një lajthim nga ana e trupit gjykues në Komision, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se ai është një pretendim i padrejtë pasi, në këndvështrim të nenit 4, paragrafi 6 i ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: *[...] Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. [...]*, natyrshëm Komisioni i është drejtuar referimit te normat e Kodit të Procedurës Administrative për të gjetur zgjidhje në situatën e konstatimit të një gabimi material në dispozitivin e vendimit të dhënë prej tij. Alternativa tjetër do të kishte qenë referimi te normat procedurale civile, përkatësisht te neni 312 i Kodit të Procedurës Civile, por duke qenë se veprimtaria e zhvilluar prej Komisionit është kryesisht e mbështetur në rregullimet e procedurës administrative, edhe ky hap procedural ka gjetur zgjidhje me të drejtë te këto norma.
43. Në këto kushte, në referim të përcaktimeve të nenit 112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, i cili parashikon: *“1. Organi publik në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme në një akt administrativ. [...]*”, Komisioni ka ndrequr gabimin material të mungesës së bazës ligjore të parashikuar nga neni 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 në dispozitivin e vendimit, duke e vendosur atë në përmbajtjen e kësaj pjese të vendimit të tij.
44. Në vlerësimin që trupi gjykues i Kolegjit i bën këtij shkaku ankimi, vlen të theksohet fakti se arrihet në konkluzionin se vërtet mungesa e përmendjes së nenit 61, pika 2 në dispozitivin e vendimit është një gabim material, meqenëse përgjatë gjithë linjës arsyetuese të vendimit dhe analizës së rrethanave e bazës ligjore për marrjen e tij, përmenden qartazi elementet e parashikuara nga neni 61, pika 2 e ligjit, që lidhen me pasjen e kontakteve të papërshtatshme nga ana e subjektit të rivlerësimit. Kështu, në arsyetimin e vendimit, Komisioni ka analizuar gjerësisht rrethanën e pasjes së kontakteve nga ana e subjektit me shtetasit F. D. e A. I., të dy të konsideruar si të përfshirë në krimin e organizuar, si kontakte të papërshtatshme të tij. Kjo analizë patjetër që kërkon zbatimin e nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 për t’u klasifikuar si një shkak për shkarkimin e subjektit. Për këto arsye, mungesa e vendosjes së kësaj dispozite në pjesën urdhëruese të vendimit nuk mund të jetë përveç se një harresë, e cila, me të drejtë, prej Komisionit është klasifikuar si një gabim material dhe është ndrequr prej tij në zbatim të nenit 112 të Kodit të Procedurave Administrative, nëpërmjet vendimit nr. 5, datë 17.09.2018. Në këndvështrim të dispozitës së mësipërme, duke qenë se ndreqja bëhet edhe kryesisht nga

organi procedues, thirrja e subjektit për t'u dëgjuar nuk ka qenë një kërkesë e ligjit dhe vetë vendimmarrja nuk ka shkelur apo prekur rishtas asnjë të drejtë të subjektit që nuk ishte e prekur ndërkohë prej vendimit të shpallur. Përfundimisht, trupi gjykues e gjen të padrejtë edhe këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit.

45. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se procesi i rivlerësimit të tij dhe vendimmarrja e trupit gjykues të Komisionit për të nuk ka respektuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, trupi gjykues i Kolegjit, duke analizuar ankimin, vendimin dhe aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, si edhe kuptimin e parimit të kontradiktoritetit sipas parashikimit të nenit 18 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *asnjë palë nuk mund të gjykohet pa u dëgjuar ose pa u thirrur*, e gjen të padrejtë dhe të pambështetur në ligj e në fakte këtë pretendim. Trajtimi dhe analiza e këtij shkak ankimi shihet nga trupi gjykues si i lidhur me shkaqet e tjera të trajtuara më sipër në lidhje me të drejtën e mbrojtjes e të drejtën për t'u dëgjuar, duke qenë se ato janë elemente përbërëse dhe ekzistenciale të zbatimit të këtij parimi.
46. Në vijim të analizës së shqyrtimit të këtij shkak ankimi, konstatohet ndër të tjera se subjekti këtë parashtrim e lidh me pretendimin që mundësia për t'u mbrojtur i është cenuar dhe kufizuar ndjeshëm jo vetëm në procesin e rivlerësimit të kryer pranë Komisionit, por edhe në kuadër të gjykimit që do të bëhet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, e cila vjen si pasojë e shkeljes së përcaktimeve të nenit 38, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 që parashikon se kontrolli i figurës zhvillohet në mënyrë objektive dhe pa ndikime të karakterit personal, armiqësor dhe miqësor, të cilat mund të favorizojnë apo disfavorizojnë subjektin e rivlerësimit. Subjekti edhe në këtë shkak ankimi pretendon se mungesa e paraqitjes në vendim të fakteve që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, jo vetëm e bën atë të pavlefshëm, por ajo pamundëson edhe kontrollin gjyqësor të vendimit nga ana e Kolegjit. Në ankim, lidhur me këtë shkak, subjekti pretendon ndër të tjera se në vendim mungon në mënyrë të shprehur konkluzioni i trupit gjykues në lidhje me raportin e DSIK-së pas hetimit të thelluar.
47. Lidhur me sa parashtruar në këtë shkak ankimi, trupi gjykues, pasi analizoi arsyetimin e vendimit nr. 52, datë 30.07.2018, të Komisionit, konstatoi se në paragrafin 84 të tij është shprehur qartë: *Në përfundim të procesit të verifikimit të figurës për subjektin e rivlerësimit Shkëlzen Selimi, arrihet në përfundimin se raporti i DSIK-së rezulton i drejtë.* Këtë qëndrim të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit e konsideron si një konkluzion për kontrollin e figurës për të cilin Komisioni është shprehur qartazi, duke e identifikuar atë jo vetëm si konkluzion të DSIK-së, por edhe si konkluzion të vetë trupit gjykues të Komisionit, pas hetimit të thelluar. Ky qëndrim i trupit gjykues të Komisionit, lidhur me vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, është krejtësisht i qartë në paragrafin 90 të vendimit nr. 52, datë 30.07.2018, i cili përcakton: *Përfundimet e nxjerra nuk i referohen këtij informacioni specifik, por konkluzioneve të nxjerra nga rezultatet e hetimit administrativ, gjykimi i fakteve relevante të paraqitura në dosje dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit.*
48. Lidhur me parashtrimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, brenda të njëjtit pretendim për shkelje të parimit të kontradiktoritetit, ku ai pretendon se nuk i janë vënë në dispozicion dokumentet e klasifikuara "sekret", trupi gjykues pa dashur të përsëritë konkluzionet e cituara më lart, vlerëson të nënvizojë qëndrimin e tij në terma fundorë se i gjithë arsyetimi

i përdorur prej Komisionit për të drejtën e tij për kufizimin e së drejtës së subjektit për t'u njohur me dokumentacionin e klasifikuar "sekret", është kryer në rastin objekt gjykimi në mënyrë proporcionale dhe pa cenuar thelbin e së drejtës të subjektit për t'u njohur me faktet që i atribuohen atij, si edhe me burimin e krijimit të tyre në funksion të garantimit të së drejtës për t'u mbrojtur. Nga analiza që i bëhet dokumentacionit të administruar, rezulton se edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk është njohur dhe nuk ka pasur akses në dokumentacionin e klasifikuar, ai është njoftuar për faktet thelbësore të dala nga dokumentacioni i klasifikuar. Ai është ftuar të japë shpjegime në lidhje me këto fakte të cilat më pas janë përdorur si shkaqe për shkarkimin e tij, konkretisht lidhja e subjektit me dy shtetasit që janë konsideruar si kontakte të papërshtatshme të tij. Subjekti gjithashtu është informuar edhe për burimet nga të cilat Komisioni ka marrë këtë informacion, të cilat janë organe ligjzbatuese të ngarkuara nga ligji me kompetencën për dhënien e këtij informacioni, si dhe atyre të shteteve të huaja partnere. Këto burime janë konsideruar nga trupi gjykues si burime të njohura në kuptim të nenit 49 pika 4 e ligjit nr.84/2016. Komisioni konstatohet se ka zhvilluar procedurën administrative në përputhje me të drejtën e brendshme, konkretisht nenin Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 e 46 të Kodit të Procedurave Administrative, dispozita të cilat i garantojnë të drejtën e palës për t'u njohur me dokumentet e dosjes së një procedure, por me kufizimin e kësaj të drejte sipas legjislacionit në fuqi, ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror". Subjektit i është dhënë aq informacion nga dokumentacioni i klasifikuar "sekret", sa e ka konsideruar të arsyeshme dhe të nevojshme për t'i garantuar atij të drejtën për t'u mbrojtur. Njëkohësisht, vetë Komisioni ka pasur akses të plotë mbi çdo dokument të klasifikuar, nga i cili kanë rezultuar faktet për të cilat ai është njoftuar. Komisioni ka pasur akses të plotë mbi dokumentacionin dhe ka bërë një analizë të tijën mbi këto të dhëna, të cilat e kanë çuar në vendimmarrjen e shpallur. Të njëjtin akses mbi këtë dokumentacion e ushtroi dhe trupi gjykues i Kolegjit të Apelit, nëpërmjet shqyrtimit e analizimit të çdo dokumenti të klasifikuar, i cili bindi trupin se të gjitha faktet që i atribuohen subjektit të rivlerësimit në arsyetimin e vendimit të Komisionit dhe për të cilat atij i ka kaluar edhe barra e provës për të provuar të kundërtën, janë të provueshme në një nivel tillë që legjitimojnë vendimmarrjen e Komisionit për shkarkimin e subjektit nga detyra. Në këto kushte, Kolegji gjen të padrejtë pretendimin e subjektit se kufizimi i imponuar nga zbatimi i normave ligjore për mosnjohjen e dokumentacionit të klasifikuar, ka cenuar zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, pasi konstaton se ky cenim nuk ka prekur thelbin e të drejtave të tij. Njëkohësisht, trupi gjykues konstaton se me të drejtë Komisioni nuk ka lejuar subjektin të ketë akses mbi dokumentacionin e klasifikuar jo vetëm për shkak të kufizimeve të ligjit, por edhe për shkak të konkluzionit sipas të cilit zbulimi i këtyre akteve do të cenonte sigurinë kombëtare, do të çonte në zbulimin e aktiviteteve të organeve ligjzbatuese që operojnë në metoda të fshehta, mund të cenonte jetën dhe shëndetin e shtetasve dhe integritetin e marrëdhënieve partnere mes qeverisë shqiptare me atë të shteteve të tjera bashkëpunuese.

49. Arsyetimi i Kolegjit në këtë rast mbështetet edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim GjEDNj) në lidhje me të njëjtin argument, të pasqyruar në vendimin e saj për çështjen *Regner kundër Çekisë*. Në çështje, Dhoma e Madhe e GjEDNj-së përsërit se parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i barazisë së armëve janë thelbësore për të pasur një proces te rregullt, por të drejtat që burojnë prej këtyre parimeve, duke përfshirë edhe të drejtën për t'u njohur me provat, nuk kanë një natyrë

absolute, për sa kohë që mund të ketë interesa konkurruese, siç është siguria kombëtare, që duhen marrë në konsideratë dhe të kenë përparësi karshi të drejtave procedurale të palëve.

50. GjEDNj-ja ka pranuar se mossigurimi i një pale me të drejtën për t'u njohur me aktet e klasifikuara si sekret shtetëror, të përdorura si provë ndaj tij (*që e konsideron si kufizim i së drejtës të palës/aplikantit në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve*) nuk përbën cenim/privim të parimit të kontradiktoritetit dhe nuk prek vetë thelbin e së drejtës së tij për një gjykim të drejtë/proces të rregullt ligjor. Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, ndër të tjera gjykata shprehet: *Gjykata përsërit se dhe e drejta për zbulimin e provave, nuk është një e drejtë absolute gjithashtu. Në rastet penale është gjetur se mund të ketë interesa konkurrues, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët nga rreziku i hakmarrjes ose mbajtja sekrete e metodave të hetimit të krimit nga ana e policisë, të cilat duhet të peshohen mirë ndaj të drejtave të palës tjetër. Megjithatë, vetëm masat që kufizojnë ato të drejta procedurale që nuk ndikojnë thelbin në vetvete të të drejtave materiale, janë të lejueshme sipas nenit 6 § 1. Për të qenë kështu, çdo vështirësi që i është shkaktuar palës ankuese nga një kufizim i të drejtave të tij ose saj, duhet të balancohet në mënyrë të mjaftueshme nga procedurat e ndjekura nga autoritetet gjyqësore.*
51. Në çështjen objekt shqyrtimi, trupi gjykues i Kolegjit konstaton, siç është pranuar edhe më lart, se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshëm njohuri mbi faktet dhe personat, të zbuluara nga të dhënat sekrete, të cilat e kanë ngarkuar atë me përgjegjësi disiplinore dhe në asnjë rast, Komisioni nuk ka kryer një vlerësim abuziv apo të njëanshëm të të dhënave të njohura prej dokumentacionit të klasifikuar “sekret”. Trupi gjykues e mbështet konkluzionin e tij edhe në të dhëna të tjera, të marra nga burime të hapura dhe zyrtare, të cilat u kanë dhënë gjithashtu kuptim ngjarjeve apo informacioneve të klasifikuara, duke i dhënë njëkohësisht subjektit të rivlerësimit mjaftueshëm dijeni për to dhe, për pasojë, duke siguruar përmbushjen e një procesi të rregullt në drejtim të garantimit të thelbit të së drejtës për t'u mbrojtur dhe të së drejtës për t'u dëgjuar.
52. Përfundimisht, trupi gjykues, edhe në këndvështrim të kësaj jurisprudence, pretendimin e subjektit se atij i është cenuar zbatimi i parimit të kontradiktoritetit dhe zbatimi i nenit 6 të KEDNj-së, e çmon të pabazuar.
53. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka zbatuar parimet minimale të procesit të rregullt e të drejtë dhe se nuk ka pasur cilësinë e një organi të tretë të paanshëm dhe se nuk mund të konsiderohet si gjykatë e krijuar me ligj, sipas nenit 6 të KEDNj-së dhe nenit 42 të Kushtetutës, trupi gjykues gjen të drejtë të arsyetojë mbi garancitë që ofron legjislacioni për procesin që zhvillon Komisioni, pavarësisht statusit *sui generis* të këtij organi.
- Për analizimin e këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues gjen të drejtë të referohet te vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, i Gjykatës Kushtetuese, i cili në pjesën arsyetuese të tij parashtron: [...] 67. *Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë*

që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.

54. Gjithashtu trupi gjykues sjell në vëmendje edhe qëndrimin e dhënë nga Komisioni i Venecias në opinionin e tij të datës 12.12.2016, lidhur me pyetjen: *A është ligji në përputhje me nenin 6 të KEDNj-së, lidhur me respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor?* – ndër të tjera, shprehet: *Sipas opinionit të Komisionit të Venecias, këto rregulla janë konceptuar për të garantuar që këto institucione të rivlerësimit të jenë tribunalë të pavarur dhe të paanshëm dhe të përshtatshëm për të përmbushur këtë qëllim [...]. Në vijim, Komisioni i Venecias, në paragrafin nr. 40 gjithashtu shprehet: Për më tepër, sipas nenit 4(6) të ligjit të vetting-ut (ligji nr. 84/2016), nëse nuk parashikohet ndryshe nga Kushtetuta apo ligji i vetting-ut, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedura që janë të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Shumë prej rregullimeve procedurale të parashikuara në ligjin e vetting-ut, që kanë të bëjnë me procedurat para Kolegjit të Apelit, janë hartuar mbi bazën e cilësimit të këtij procesi si një “proces gjyqësor”, duke qenë se ato parashikojnë zbatimin – ose jo – të rregullimeve që kanë të bëjnë me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative (shih, për shembull, nenet 62(3), 63(2) dhe 65(1) të ligjit nr. 84/2016.*

Duke u mbështetur në këto qëndrime të Gjykatës Kushtetuese dhe të Komisionit të Venecias, institucione që kanë bërë interpretime të dispozitave ligjore të ligjit nr. 84/2016 në raport me kushtetutshmërinë e tyre, por edhe me respektimin e parimeve të njohura të KEDNj-së, përfshi edhe parimin e procesit të rregullt ligjor, brenda kornizave të tyre funksionale, Kolegji shprehet se, pavarësisht nga titullimi ose jo gjykatë i trupave gjykues në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, detyrimi që ato kanë për zhvillimin e procesit të rivlerësimit, në zbatim të rregullimeve të ligjit nr. 84/2016 të cituara më lart, garanton zhvillimin prej tyre të një procesi të rregullt ligjor që përmbush rekuizitat kushtetuese dhe ato të parashikuara nga KEDNj-ja, në drejtim të garantimit të një procesi të rregullt, prandaj edhe ky pretendim i subjektit konsiderohet si i pambështetur.

55. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe pretendimin se mungojnë vendimet e ndërmjetme të trupit gjykues për marrjen e provave të sjella nga subjekti dhe, për pasojë, mungon edhe vlerësimi i tyre. Kjo, sipas subjektit, ka sjellë shkelje të parimit “të barazisë së armëve”, pasi asnjë provë nga provat e kërkuara prej tij nuk është administruar dhe marrë në shqyrtim, gjë e cila passjell pavlefshmërinë absolute të vendimit të Komisionit, si rezultat i një procesi të paragykuar dhe i mosbërjes së një analize të provave të paraqitura gjatë procesit nga subjekti.

56. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues i Kolegjit, pas një analize të plotë të përmbajtjes së vendimit nr. 52, datë 30.07.2018, konkludon se jo vetëm që trupi gjykues i Komisionit i ka marrë në shqyrtim dhe i ka përmendur në vendim provat e subjektit, por konstatohet se ai realisht i ka vlerësuar ato në raport me të gjitha provat e tjera që janë administruar gjatë hetimit administrativ. Në këtë përfundim arrihet duke u referuar në paragrafin 45.2, paragrafin 56.2, paragrafin 62.2, paragrafin 76.1 të vendimit, të cilët listojnë të gjitha provat e paraqitura gjatë hetimit administrativ nga subjekti i rivlerësimit dhe paragrafët vijues të tyre në të cilët jepet qëndrimi i trupit gjykues në lidhje me to dhe vlerën provuese të tyre. Fakti që Komisioni nuk ka mbështetur në vendimin e

tij pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të cilin ai ka menduar se e ka provuar me provat e sjella, nuk dëshmon mungesë të analizës e vlerësimit të provave, por një analizë që ka prodhuar një konkluzion të ndryshëm nga qëndrimet e subjektit, çka përbën një vendimmarrje që konsiderohet se është e drejtë dhe detyrim kushtetues i Komisionit. Përveç sa më sipër, subjekti nuk parashtron asnjë pretendim të adresuar drejt refuzimit apo mosvlerësimit të ndonjë prove në veçanti, për të cilën Komisioni nuk ka marrë një vendim të ndërmjetëm. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit edhe pretendimin e subjektit se mospasja e një vendimi formal nga Komisioni për marrjen e provave ka cenuar procesin e rregullt, gjendet i pambështetur.

B. Shkaqet që lidhen me pretendimet e subjektit për analizim të gabuar të situatës faktike

57. Në ankim dhe parashtrime, subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin për mungesa në arsyetimin e vendimit, pasqyrim të pasaktë e të rremë të rrethanave të faktit dhe konkluzioneve alogjike. Ai ka paraqitur një sërë shkaqesh që, sipas tij, lidhen me pasqyrimin e rremë e të gabuar të të dhënave e fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ, duke aluduar përgjatë gjithë ankimit se Komisioni ka qenë në analizën e tij i njëanshëm, i palogjikshëm dhe i pambështetur në ligj.
58. Trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi në mënyrë të detajuar gjatë gjykimit të kësaj çështje të gjitha shkaqet e ankimit të ngritura prej subjektit të rivlerësimit, që ngrinin pretendime në lidhje me situatën faktike të çështjes. Para se të parashtrohet arsyetimi i trupit gjykues në lidhje me këto shkaqe, më poshtë paraqitet një panoramë e përmbledhur e fakteve të përmendura prej Komisionit, për të cilat subjekti i rivlerësimit është konsideruar se ka plotësuar kushtet për t'u konsideruar i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës në kuptim të nenit Dh, pikat 4 e 5 të Aneksit të Kushtetutës e nenit 61, paragrafët 2 e 3 të ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, Komisioni ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra.
59. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Selimi ka pasur kontakte të papërshtatshme me shtetasin F. D., person i cili, sipas urdhrit të Prokurorit të Krimeve të Rënda, më datë 19.01.2018, është marrë si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale, duke qenë se është urdhëruar regjistrimi i emrit të tij si individ që i atribuohet vepra penale e parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 i Kodit Penal, lidhur me procedimin penal {***}, të regjistruar më datë {**}.{**}.2013. Më pas, për shtetasin F. D., me vendimin nr. {***}, datë {**}.{**}.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, është caktuar masa e sigurimit personal “arrest me burg” për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”. Vepra penale për të cilën është proceduar ky shtetas bën pjesë në parashikimet e nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Për pasojë, në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, ky shtetas konsiderohet si person i përfshirë në krimin e organizuar. Gjatë hetimit të zhvilluar nga Komisioni, nëpërmjet analizës së të dhënave të marra nga agjencitë ligjzbatuese, por edhe nga përgjigjet e dhëna nga vetë subjekti, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka një miqësi të gjatë me këtë shtetas dhe familjen e tij. Ai vetë ka pohuar gjatë kthimit të përgjigjeve në pyetësor (me *e-mail*-in e datës 13.02.2018) se marrëdhënia e tyre është familjare, e shëndoshë dhe afatgjatë, që prej 13 vitesh, kur ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë. Subjekti e cilëson shembullor

këtë shtetas dhe familjen e tij. Ai ka shprehur përgjatë gjithë përgjigjeve të dhëna në Komision se e vlerëson mënyrën e jetesës së këtij shtetasi dhe familjes së tij, të cilën e ka atashuar pranë të vetes pikërisht për shkak të këtyre arsyeve. Në përgjigjet e dhëna Komisionit, subjekti (në datat 14.02.2018 e 19.02.2018) ka pohuar se ka qenë në dijeni vetëm të ngjarjes kriminale të ndodhur në vitin 2011, në të cilën është ndaluar dhe proceduar penalisht shtetasi D. për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, dhe se për të është vënë në dijeni më pas dhe madje e ka qortuar shtetasin F. D. për këtë veprim jokorrekt në raport me ligjin. Për sa i përket aktivitetit kriminal të shtetasit F. D. në fushën e trafikimit të narkotikëve, subjekti në shpjegimet e tij për rezultatet paraprake të hetimit të Komisionit shprehet se është vënë në dijeni vetëm pasi emri i këtij shtetasi është regjistruar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, në janar të vitit 2018.

60. Në lidhje me shtetasin F. D., subjekti ka pretenduar se në raportin e DSIK-së dhe në vendimin e Komisionit mungon analiza nëse papërshtatshmëria ka ardhur për shkak të një raporti të krijuar për shkak të detyrës apo për shkak të njohjes shoqërore me këtë shtetas. Trupi gjykues, në përgjigje të këtij shkak, konkludon se pretendimi i subjektit është i pambështetur në fakte e në ligj, duke arsyetuar si më poshtë.

Së pari, duhet të nënvizohet fakti se detyrimi i DSIK-së për t'u shprehur për përshtatshmërinë ose jo të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën buron nga parashikimi i nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton: [...] *DSIK në raportin për kontrollin e figurës shprehet për konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës.* Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se DSIK-ja, me anë të shkresës që është administruar në Komision më datë 15.11.2017, në cilësinë e organit kompetent, është shprehur për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi për vazhdimin e detyrës, duke parashtruar:

[...] *Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit evidentojnë rrethanat e konstatimit të faktit se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me person/persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas përcaktimit të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 në formën e shkëmbimit të parave, favoreve apo dhuratave, në papajtueshmëri të plotë me detyrën.*

Përveç sa më sipër, në raportin e saj, DSIK-ja në pikën 2 shprehet:

Informacionet që disponohen në ngarkim të tij, për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë në më shumë se një rast, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë/tërthorazi të çfarëdo përfitimi të parregullt për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e tij funksionale, e bën subjektin e rivlerësimit në mbështetje të germave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, person me tendencë për përfshirjen në veprimtari kriminale dhe një individ që mund të vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale.

Në lidhje me konstatimin e sa pasqyruar qartazi nga DSIK-ja, në raportin e saj për figurën e subjektit Shkëlzen Selimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka kryer një hetim të pavarur, nga i cili ka administruar si nga përfaqësuesit e ONM-së, ashtu edhe nga organet ligjzbatuese vendase të dhëna, të marra nëpërmjet dokumentacionit të klasifikuar “sekret”, ku dëshmohet se si ky gjyqtar ka ushtruar ndikimin e tij me qëllim favorizimin e personave të lidhur me krimin e organizuar.

61. Pavarësisht konkluzionit që paraqet në raport DSIK-ja, konkluzioni i Komisionit në lidhje me shtetasin F. D. përmban elemente të nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sepse ky shtetas rezulton të jetë i përfshirë në krimin e organizuar dhe njëkohësisht është një lidhje shoqërore e subjektit të rivlerësimit. Marrëdhënia e ngushtë e subjektit me këtë shtetas, afatgjatë e për më tepër konsideruar prej tij si e shëndetshme dhe e afërt, e bën të pabesueshëm pretendimin e subjektit se ai nuk ka qenë asnjëherë në dijeni të aktivitetit kriminal të këtij shtetasi.

Trupi gjykues çmon të nënvizojë faktin se këndvështrimi për lidhjet shoqërore që duhet të ketë çdo shtetas i ndërgjegjshëm i një vendi, aq më shumë një funksionar i lartë, siç është rasti i subjektit të rivlerësimit, duhet të shoqërohen nga kultura e njëjtë e përbashkët e interesat e ndërsjella dhe ndarja e vlerave të njëllota që karakterizojnë një qytetar korrekt. Lidhja e gjatë shoqërore e subjektit me këtë shtetas, e bën të pamundur e naiv shpjegimin që ai jep për natyrën e marrëdhënies mes tyre, si të afërt e të shëndetshme, por në padijeni të aktivitetit e mënyrës së jetesës së secilit. Subjekti presupozohet që për shkak të kësaj marrëdhënieje dhe pozitës e aftësive të tij njohëse, që lidhen edhe me profesionin, të ketë ditur natyrën e aktivitetit në të cilin ishte përfshirë shtetasi F. D., aq më tepër që siç pohon edhe vetë ka qenë në dijeni të paktën të një ngjarjeje kriminale të ndodhur në vitin 2011 dhe e ka qortuar për të. Ndërkohë që nga aktet e administruara në dosje, rezulton që vërtet emri i shtetasit F. D. është regjistruar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale në vitin 2018, por procedimi penal për veprën penale të trafikimit të narkotikëve, të referuar nga policia për grupin kriminal në të cilin bënte pjesë edhe ky shtetas, është bërë që në vitin 2013, madje një pjesë e të pandehurve të këtij grupi është dërguar për gjykim, çka nënkupton me shumë gjasa faktin që emri i këtij shtetasi, ndonëse jo me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, por si të një personi të përfshirë në këtë aktivitet, të jetë shfaqur ndoshta në dokumentacionin e dosjes gjyqësore përkatëse, duke e bërë këtë rrethanë një element që duhej të kishte tërhequr vëmendjen e subjektit të rivlerësimit. I gjithë ky arsyetim sigurisht që bëhet relevant për shkak të afërsisë dhe lidhjes miqësore që vetë subjekti përshkruan në raport me këtë shtetas. Për shkak të këtyre argumenteve, bëhet i pabesueshëm pretendimi i subjektit për mosdijeninë e aktivitetit të tij, në kuptim të nenit 38, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues e konsideron të drejtë vlerësimin e Komisionit se kjo lloj marrëdhënieje e subjektit me këtë individ ka afektuar dhe afekton subjektin e rivlerësimit në ushtrimin e detyrës. Referuar në sa pasqyruar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon se Komisioni ka analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të pavarur marrëdhënien e subjektit me F. D. dhe vetëm pas administrimit të dokumentacionit të sipërcituar, ka krijuar bindjen se F. D. përbën një kontakt të papërshtatshëm për subjektin dhe se, nga ana tjetër, konstatohet që subjekti në asnjë fazë të procesit të rivlerësimit pranë Komisionit, por as në ankim, nuk ka paraqitur prova apo fakte që dëshmojnë të kundërtën dhe madje as që dëshmojnë se marrëdhënia e tij me këtë shtetas ka përfunduar me zbulimin e këtyre të dhënave.

62. Në lidhje me pretendimet që i referohen situatës faktike, subjekti i rivlerësimit parashtron se trupi gjykues i Komisionit ka shprehur njëanshmërinë nëpërmjet pasqyrimit në vendim të fakteve të shtrembëruara, kjo si për faktet me natyrë procedurale, ashtu edhe ato materiale, të cilat kanë qenë objekt i hetimit kryesisht. Kjo, sipas subjektit, është bërë duke synuar të krijojë perceptimin tek opinioni publik se subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Selimi është një gjyqtar problematik, të cilit kontaktet e papërshtatshme nuk i numërohen,

duke pasqyruar në vendim edhe kontaktet me persona që ligji nuk i kërkon të deklarohen dhe as të jepen shpjegime apo barrë prove.

63. Në lidhje me këtë pretendim, që konkretisht ka të bëjë me përmendjen e shtetasve I. Ç. e A. D. si kontakte të subjektit, nga shqyrtimi i dosjes konstatohet se në funksion të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të figurës, Komisioni, duke marrë shkas edhe nga dokumentacioni i klasifikuar “sekret”, i sjellë për subjektin nga agjencitë ligjzbatuese, për kontaktet e identifikuara në këtë informacion ka kryer verifikimet përkatëse në strukturat përgjegjëse, por edhe është përpjekur të marrë më shumë informacion nëpërmjet komunikimeve me subjektin. Në këtë kuptim, në funksion të garantimit të një procesi të drejtë dhe të plotë rivlerësimi, Komisioni të gjitha veprimet procedurale dhe hetimore të ndërmarra prej tij, ia ka vënë në dijeni subjektit të rivlerësimit në fazën e njoftimit të rezultateve paraprake të hetimit administrativ. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni të gjitha verifikimet e kryera për individë për të cilët kishte rekorde apo informacione për përfshirje në vepra penale nga agjencitë ligjzbatuese, me të drejtë i ka pasqyruar në vendimin e tij, edhe pse këta individë, ashtu siç pretendon subjekti, nuk klasifikoheshin sipas pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si persona të përfshirë në krimin e organizuar. Ky qëndrim i trupit gjykues të Komisionit është bërë për të dhënë një tablo të plotë të ambientit shoqëror tek i cili subjekti i rivlerësimit ka zgjedhur të bëjë pjesë.
64. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues i Kolegjit gjithashtu vlerëson se paraqitja në vendim e këtyre të dhënave, përfaqëson jo vetëm rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni, por edhe është një funksion i përmbushjes së një prej qëllimeve të kryerjes së reformës në drejtësi, të cituar shprehimisht në nenin 179, germa “b”, paragrafi i parë i Aneksit të Kushtetutës, i cili është rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë. Për më tepër, organet e rivlerësimit kanë gjithashtu edhe detyrimin tjetër kushtetues, që buron nga neni Ç i Aneksit të Kushtetutës, për të informuar publikun nëpërmjet publikimit të vendimeve të tyre dhe pasqyrimin në këto vendime të informacioneve që ndihmojnë në perceptimin e saktë prej publikut të rrethanave që kanë çuar në shkarkimin e subjektit, por edhe të rrethanave të tjera që përshkruajnë kriteret e procesit të rivlerësimit.
- Kolegji vlerëson se përshkrimi i këtyre të dhënave prej Komisionit, në vendim është bërë gjithsesi në kuptim dhe zbatim të saktë të nenit A të Aneksit të Kushtetutës, dispozitë e cila në funksion të këtij procesi, kufizon disa nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut për subjektet e rivlerësimit, por që gjithsesi mbeten të pacenuara nën nivelin e kufizimeve të parashikuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, sipas parashikimeve të nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për sa është analizuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se paraqitja e këtyre të dhënave, përveç se plotëson panoramën sociale në të cilën ka jetuar subjekti i rivlerësimit, e cila u jep kuptim edhe gjetjeve e konkluzioneve të Komisionit, nuk cenon asnjë nga të drejtat e pretenduara të subjektit dhe as procesin e rregullt ligjor.
65. Lidhur me parashtrimin e subjektit të rivlerësimit se në vendim përmenden fakte të pahetuara, të pavërteta dhe të shtrembëruara që lidhen me pronësinë automjetit BMW, me targë {***}, trupi gjykues nga analiza e dokumentacionit të administruar konstaton se ky pretendim nuk qëndron.

66. Automjeti BMW, me targë {***}, është automjeti me të cilin ka udhëtuar shtetasi F. D. në kohën që është ndaluar prej forcave të policisë në vitin 2011 dhe i është gjetur që mbante një armë zjarri, pistoletë e tipit “bereta”, pa leje të organeve kompetente. Për këtë ngjarje kriminale, organi i prokurorisë ka nisur hetimet duke proceduar penalisht këtë shtetas për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake e të municioneve”, të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, dhe përfundimisht ai është deklaruar fajtor e është dënuar për këtë veprë penale me vendimin nr. {***}, datë {**}. {**}. 2012, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Nga Komisioni është hetuar mbi emrin e individit i cili ka qenë pronar i automjetit BMW, pasi për këtë automjet në vitin 2011 kanë pasur policë sigurimi TPL, në emër të tyre, subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Selimi dhe bashkëshortja e tij, Rilinda Selimi. Nga analiza e akteve të administruara, trupi gjykues ka konstatuar se ky automjet në datën kur për të kanë prerë policë sigurimi subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, rezulton të ketë qenë në pronësi të shtetasit R. H. . Ky i fundit, më datë 01.08.2011, ia ka shitur automjetin shtetasit I. Ç. dhe polica e sigurimit të detyrueshëm (TPL) në favor të subjektit dhe bashkëshortes së ka qenë në fuqi edhe gjatë kohës që pronar i tij u bë shtetasi I. Ç. dhe mjeti u sekuestrua në cilësinë e provës, më datë 27.11.2011, ditë në të cilën shtetasi F. D. u ndalua në drejtim të këtij automjeti për mbajtje pa leje të armëve luftarake. Fakti se polica e sigurimit TPL është prerë prej subjektit dhe bashkëshortes së tij para se pronar i mjetit të bëhej shtetasi I. Ç., nuk e bën të pavërtetë faktin e rëndësishëm për këtë proces, se në kohën kur ky shtetas është bërë pronar i mjetit, kjo policë ka vazhduar të jetë e vlefshme dhe e tillë ka qenë edhe në kohën kur automjeti me pronar shtetasin I. Ç. është sekuestruar për llogari të procedimit penal të përmendur më lart. Ky fakt tregon jo vetëm për ushtrimin e të drejtave të përdorimit të këtyre individëve mbi këtë mjet, por edhe për lidhjet që subjekti ka pasur me këta persona, të cilat janë pranuar edhe prej atij vetë gjatë përgjigjeve të dhëna gjatë hetimit administrativ. Për këto arsye, Komisioni ka analizuar në vendim lidhjen e subjektit edhe me shtetasin I. Ç., pavarësisht se ai nuk është një person i përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, por është pavarësisht një individ i konsideruar si kontingjent i organeve që ushtrojnë funksione parandaluese në drejtim të veprimtarive kriminale për ato vepra që janë cituar prej Komisionit.
67. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për njëanshmëri të trupit gjykues të Komisionit për përkufizimin e shtetasit I. Ç. dhe A. D. si persona të përfshirë në krimin e organizuar, duke pretenduar se këta shtetas nuk janë proceduar penalisht, trupi gjykues konstaton se Komisioni të dhënat për precedentë penalë për këta shtetas i ka marrë nga një kontroll në sistemin TIMS në kuadër të hetimit të kryer, ku emri i I. Ç. ka dalë si pronar i automjetit BMW, të cilin e drejtonte në momentin e arrestimit të F. D., ndërsa shtetasi A. D. ka dalë në cilësinë e një personi tjetër të lidhur të cilit subjekti i ka shitur automjetin e tij, që më pas ka rezultuar të ketë edhe një marrëdhënie kontraktuale shitblerjeje me babain e subjektit të rivlerësimit. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se shtetasi I. Ç. është një person që ka pasur precedentë penalë në fushën e krimeve kundër jetës dhe është mbajtur nën vëzhgim policor për këtë arsye. Ndërsa shtetasi A. D., me profesion avokat, ka qenë i proceduar për veprën penale të “Mashttrimit”. Ndërkohë që subjekti i rivlerësimit gjatë përgjigjeve të pyetësorëve të Komisionit (me *e-mail*-e të datave 21 dhe 22 shkurt 2018) pranon lidhje me këta shtetas, bën vlerësim për figurën dhe reputacionin e tyre dhe sigurisht nuk pranon asnjë lidhje me çdo aktivitet të

kundërligjshëm që ata mund të kenë, pavarësisht se ai nuk është në dijeni për asgjë të kësaj natyre.

68. Nga shqyrtimi i vendimit nr. 52, datë 30.07.2018, të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nga Komisioni këta individë nuk janë cilësuar si persona të përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016 dhe për ta subjektit nuk i ka kaluar barra e provës. Këta shtetas janë trajtuar prej Komisionit si persona që kanë rekorde kriminale, pavarësisht se jo të atij lloj që i përfshin ata te personat e krimin të organizuar, por sidoqoftë janë individë të cilët në kuptim të garantimit të figurës së një gjyqtari të lartë, nuk do të duhej të bënin pjesë në rrethin e tij shoqëror, pikërisht për shkak të aktiviteteve të tyre të kundërligjshme. Trupi gjykues çmon se me të drejtë Komisioni i ka konsideruar ata si rreth personash që, për shkak të raportit e marrëdhënies së ngushtë që kanë krijuar me subjektin, në njëfarë mënyre e cenojnë figurën e tij. Kjo e dhënë, pavarësisht se nuk përbën një shkak të mirëfilltë shkarkimi, ka shërbyer për Komisionin si argument, ndër të tjera, për të arritur në konkluzionin se subjekti mund të vihet lehtësisht nën presionin e strukturave kriminale, për sa kohë që individë të cilët janë pjesë e këtyre strukturave, rezultojnë të jenë lidhje e tij shoqërore në mënyrë jorastësore e të qëndrueshme. Për sa argumentuar më sipër, trupi gjykues këtë shkak ankimi e gjen të pabazuar.
69. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ngre edhe pretendimin që lidhet me rrethanat e faktit në ngjarjen e ndodhur në vitin 2011, në të cilën është përfshirë shtetasi F. D.. Trupi gjykues konstaton se në vendimin e Komisionit, asnjë prej elementeve të pretenduara prej subjektit në ankim nuk është bërë pjesë e analizës apo konkluzioneve, përveç se marrëdhënia e subjektit me personat e përfshirë në këtë ngjarje, që pranohen edhe prej tij, në këndvështrim të përkufizimit të ambientit shoqëror që ka frekuentuar ai. Për këto arsye, trupi gjykues pretendimet e tij në lidhje me detaje të kësaj shtate, që nuk janë përfshirë në vendimmarrje dhe as janë përdorur nga Komisioni si shkaqe për shkarkimin e subjektit, i gjen të panevojshme për t'i arsyetuar më tej.
70. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se gjatë hetimit administrativ nuk i është adresuar asnjë pyetje në lidhje me shtetasin A. I., duke mos i dhënë në këtë mënyrë mundësi të mbrohet në këtë drejtim. Pasi shqyrtoi aktet e fashikullit, trupi gjykues arriti në përfundimin se edhe ky pretendim i subjektit është i pambështetur dhe i padrejtë, duke arsyetuar si më poshtë.
71. Emri i shtetasit A. I. dhe marrëdhënia e tij me subjektin e rivlerësimit Shkëlzen Selimi ka rezultuar e provuar nga “gjetja” e paraqitur nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, në kuptim të nenit 49, paragrafi 10, i ligjit nr. 84/2016. Shtetasi A. I. rezulton të jetë ndjekur penalisht nga autoritet italiane të drejtësisë për veprën penale “Pjesëmarrje në organizatë kriminale, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike”, e cila përfshihet te parashikimet e nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin e goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, për pasojë në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, ky shtetas konsiderohet si person i përfshirë në krimin e organizuar. Në kuptim të kësaj dispozite, vlera provuese e kësaj prove është ajo e një akti ekspertimi, pra një provë e cila me vështirësi mund të vihet në dyshim për vlerën e saj provuese nga çdo trup gjykues që do të duhet ta vlerësojë, pikërisht për shkak të veçorive të saj dhe burimit nga

i cili është marrë. Ky i fundit, për shkak të nivelit të besueshmërisë, integritetit dhe paañësisë e profesionalizmit, vlerësohet se ka vlerë të veçantë krahas natyrës tepër specifike të mënyrës së mbledhjes së informacionit. Sipas kësaj gjetjeje, subjekti i rivlerësimit jo vetëm që ka lidhje të qëndrueshme me shtetasin A. I., por ai ka përdorur influencën e tij në sistemin e drejtësisë, qoftë nëpërmjet vendimeve të tij të drejtpërdrejta, por edhe ndikimit të funksionarëve të tjerë që ekstradimi i këtij shtetasi drejt shtetit italian, në vitin 2014, të dështojë.

72. Nga shqyrtimi i dosjes, rezulton se trupi gjykues i Komisionit i ka përcjellë subjektin të rivlerësimit konkluzionet e kësaj gjetjeje me rezultatet paraprake të hetimit. Në këtë akt, Komisioni shprehet qartazi se atij i kalohet barra e provës për mosdeklarim të lidhjeve të tij me shtetasin A. I. Ndërkohë që rezulton se, pavarësisht kalimit të barrës së provës në lidhje me këtë shtetas, subjekti në shpjegimet e dhëna për rezultatet paraprake të hetimit, në asnjë rast, nuk shprehet direkt nëse ai ka pasur marrëdhënie konkrete me këtë shtetas, por shpjegon se nuk kishte si të dinte që familjari i tij i largët, A. Sh. , ishte shofer i shtetasit A. I.. Më tej, te shpjegimet e tij për rezultatet paraprake të hetimit, subjekti shprehet edhe për procesin e gjyqimit nga ana e tij të masës së sigurisë së shtetasit A. I., duke pretenduar se ai nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në ankim, ashtu edhe në komentet e dhëna për rezultatet paraprake të hetimit, duke dhënë shpjegime të tërthorta rreth lidhjeve të tij me shtetasin A. I.. Ai asnjëherë, as në ankim, nuk mban një qëndrim të qartë në lidhje me çështjen nëse ai ka apo jo kontakte me këtë shtetas, ndërkohë që përpiqet të japë arsye që të bindë trupin gjykues se përse ai nuk duhet të ketë marrëdhënie me këtë shtetas. Subjekti në mënyrë të pakuptimtë shpjegon se ai nuk ka ndikuar as te bashkëshortja e tij, që në funksionin si gjyqtare në qytetin e Fierit, të mund të favorizonte shtetasin A. Sh. dhe A. I.. Ky koment duket se është i pavlerë dhe i pakërkuar, ndërkohë që një kërkim i thjeshtë në internet provon se vetë subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendime gjyqësore për shtetasin A. I., ndërkohë që barra e provës i ka kaluar për veprime të tij të drejtpërdrejta dhe jo për influencën e bashkëshortja e tij.

73. Nga aktet e administruara gjatë hetimit të kësaj çështjeje, rezulton se me vendimin nr. {***}, datë {**}.{**}.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin subjekti ka qenë në cilësinë e gjyqtarit relator, është shqyrtuar rekursi i shtetasit A. I., i cili ka kërkuar “Shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë {**}.{**}.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë, heqjen e masës së sigurimit dhe konstatimin e moskompetencës së gjykatave të Tiranës”. Me anë të këtij vendimi, trupi gjykues ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. {***}, datë {**}.{**}.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Me fjalë të tjera, trupi gjykues ku subjekti ishte gjyqtar relator konstatoi moskompetencën, duke pranuar pjesërisht rekursin e A. I. dhe duke dhënë kështu një vendim në favor të tij. Në vijim të historisë procedurale të kësaj çështjeje dhe të të dhënave që rezultojnë nga “gjetja”, konstatohet se ky vendim i marrë prej trupit gjykues në të cilin subjekti ka qenë relator, ka ndikuar përfundimisht në marrjen e një vendimi refuzimi për ekstradimin e shtetasit A. I. në Itali.

Gjithashtu, vihet re që subjekti i rivlerësimit përpiqet të shpjegojë natyrën e marrëdhënies së tij e të bashkëshortes me shtetasin A. Sh., i cili nga faktet e dala nga një procedim penal në ngarkim të shtetasit A. I., rezulton të jetë shoferi personal i këtij të fundit. Ndërkohë që edhe në këto shpjegime, subjekti përsëri nuk mban asnjë qëndrim në lidhje

me marrëdhënien e tij me shtetasin A. I.. Ky qëndrim i tij konsiderohet si jo i sinqertë dhe në përpjekje për të fshehur marrëdhënien e tij me shtetasin A. I., por duke shmangur pohime apo mohime të drejtpërdrejta të faktit, në tentativë të një qëndrimi ambig, i cili mund të trajtohet në disa këndvështrime. Për trupin gjykues, ky qëndrim përbën në thelb një përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të fshehur marrëdhënien me këtë shtetas, në kuptim të nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ai nuk ka pasur mundësi të mbrohet e të shpjegohet në lidhje me këtë shtetas, mbetet i padrejtë.

74. Lidhur me kundërshtimet e subjektit në lidhje me gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar për përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, të shfaqur në formën e ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, me qëllim mosekstradimin e shtetasit A. I., trupi gjykues i Kolegjit arsyeton si më poshtë rreth vlerës së kësaj prove atipike, të parashikuar nga legjislacioni për procesin e rivlerësimit:

Rezulton se në dosjen e KPK-së, në fashikullin nr. 3, është e administruar shkresa nr. {***}, datë 04.07.2018, e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), drejtuar trupit gjykues për procesin e rivlerësimit të subjektit Shkëlzen Selimi ku thuhet:

Bazuar në dokumentacionin e marrë nga burime të sigurta dhe të besueshme konfidenciale nga qeveritë e shteteve të huaja, ONM ju ofron këtë gjetje bazuar në parashikimet e nenit 49, pika 5 dhe 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016. Kjo është një provë dhe rekomandon fuqishëm që subjekti Shkëlzen Selimi është i përfshirë në kontakte të papërshtatshme (sipas nenit 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016) direkt dhe indirekt në interes të A. I., i njohur edhe si A. Q. , i cili është i përfshirë në krimin e organizuar (sipas parashikimeve të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016). Si rezultat i ndërhyrjes së z. Selimi në korrik 2015, kërkesa për ekstradim e I. në Itali u rrëzua dhe ai doli nga burgu.

Në referencë të parashikimeve ligjore, nenit B, pika 3, germa “b” e Aneksit të Kushtetutës që parashikon: *[Vëzhguesi ndërkombëtar] paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelimit, si dhe kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit Dh, si dhe nenit 49, pikat 5 dhe 10 të ligjit nr. 84/2016, të cilat parashikojnë:*

[...] 5. Dokumentet dhe të dhënat e marra nga burimet e shteteve të tjera, në përputhje me këtë ligj, vlerësohen nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit. [...]

[...] 10. Gjetja, e paraqitur në formën e një deklaratë, dokumenti ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji i Apelimit e çmon gjetjen si të barasvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelimit.[...]

Në lidhje me këtë shkak, trupi gjykues ka analizuar edhe më sipër rreth vlerës provuese të kësaj prove në kuadër të procesit të rivlerësimit, si edhe të kufizimeve ligjore që shoqërojnë përdorimin e këtij lloji informacioni për shkak të burimit të tij, por mbi të gjitha, trupi gjykues ka konstatuar se nga hetimi administrativ që ka bërë Komisioni, të dhënat e pasqyruara në këtë provë të sjellë nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, janë konfirmuar dhe janë mbështetur. Konkretisht, historiku procedural i çështjes që lidhet me ekstradimin e shtetasit A. I. për llogari të një procedimi penal në shtetin italian,

si dhe ndikimi i subjektit të rivlerësimit në këtë proces kanë rezultuar të jenë pothuaj një konfirmim i rrethanave të përshkruara në gjetjen e cituar. Në këto rrethana, vlera e saj provuese është bërë edhe më e rëndësishme në këtë proces dhe, me të drejtë, ka ndikuar në bindjen e trupit gjykues se shtetasi A. I. është një kontakt i papërshtatshëm i subjektit të rivlerësimit dhe se ai është përpjekur të ushtrojë ndikimin e tij për të dështuar procesin e ekstradimit të këtij shtetasi drejt Italisë, rrethanë kjo që e bën atë të gjendet në kushtet e nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Në vijim të këtij konkluzioni, fakti që subjekti nuk e ka deklaruar marrëdhënien me këtë shtetas në formularin për kontrollin e figurës, pavarësisht se rezulton që ky kontakt të ketë ekzistuar, e bën subjektin të gjendet në kushtet edhe të nenit Dh, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke kryer deklaram të pamjaftueshëm.

75. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për natyrën hakmarrëse të informacionit, referuar nga ShISh, dhe gjendjen e konfliktit të interesit të këtij institucioni në raport me subjektin, trupi gjykues konstaton se është një pretendim i pambështetur në ligj.
76. Subjekti i rivlerësimit argumenton në këtë parashtrim se dhënia e një raporti negativ nga kjo strukturë për figurën e tij, ka një natyrë hakmarrëse, të bazuar në fakte të pavërteta dhe është bërë nga ShISh në mënyrë të qëllimshme, për shkak të qëndrimit që subjekti ka mbajtur në gjykimin e çështjeve sensitive, ku të përshtirë kanë qenë zyrtarë të lartë të këtij shërbimi, duke u shprehur se ai është në konflikt me këtë institucion, pasi vota e tij si gjyqtar ka qenë përcaktuese në një çështje të rëndë penale, ku ishin përfshirë drejtuesit e tij. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se, bazuar në përcaktimet e nenit 36 të ligjit nr. 84/2016, struktura përgjegjëse për verifikimin e figurës së subjekteve është DSIK-ja dhe jo ShISh-i. Kjo strukturë për më tepër, është konsideruar edhe nga vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, si një strukturë ndihmëse në procesin e rivlerësimit, duke u dhënë peshën përcaktuese në këtë proces organeve të rivlerësimit, siç janë Komisioni dhe Kolegji.
77. Trupi gjykues edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit për konflikt të tij me ShISh-in për të cilin as nuk paraqiten prova apo pretendime të qenësishme, e konsideron të pabazuar dhe në tejkalim të ligjit për konfliktin e interesit, ku si i tillë konsiderohet konflikti midis dy individëve dhe jo midis një individi (në këtë rast, subjekti i rivlerësimit) dhe një strukture shtetërore, si ShISh.
78. Në mbështetje të këtij qëndrimi, trupi gjykues çmon të referojë tek arsyetimi i vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, i cili analizon dhe interpreton rolin dhe peshën e secilit institucion në procesin e rivlerësimit dhe i jep përgjigje edhe pretendimit të ngritur nga subjekti në këtë shkak ankimi:

[...] 40. Në përfundim, Gjykata vlerëson se dispozitat e ligjit garantojnë aksesin në të gjithë informacionin dhe dokumentet e disponuara nga grupi i punës, dhe garantojnë kontrollin efektiv mbi veprimtarinë e grupeve të punës nga KPK-ja. Organet e tjera, të cilat janë të përfshira në procesin e rivlerësimit, kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale që kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rastet, autoriteti vendimmarrës mbetet tek organet e rivlerësimit (KPK-ja dhe KA-ja) të krijuara për këtë qëllim në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme.

41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.

Në konkluzion dhe në përfundim të arsyetimit të mësipërm dhe të shqyrtimit të çështjes në tërësinë e saj, trupi gjykues çmon se ankimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron në tërësinë e tij dhe se asnjë prej shkaqeve të paraqitura prej tij nuk cenon bazueshmërinë në fakte e ligj të vendimit nr. 52, datë 30.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, prandaj, si i tillë, ai duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin Dh, pikat 4 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 61, pikat 2 e 3 dhe në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 52, datë 30.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
- U shpall në Tiranë, më datë 07.02.2019.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

Nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

Nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

Nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

Nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

Nënshkrimi

[Vendimi nr. 3/1, datë 19.04.2019, me objekt: Ndreqja e gabimeve materiale në vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 3 \(JR\), datë 07.02.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi.](#)